

VENDIM
Nr.30, datë 23.05.2006

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13, pika 1 germa a, të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.26, datë 13.05.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s,” ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.05.2005, neni 11 germa A, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.46, datë 14.10.2004 “Licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga centralet ekzistuese me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW”, pjesa “Dispozita të përgjithshme” pika 1.4, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 23.05.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Projeksion” sh.p.k. për transferimin e licencës së mbajtur nga shoqëria “Sarmier” sh.p.k. për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës, për transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria “Sarmier” sh.p.k. te shoqëria “Projeksion” sh.p.k.
2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe i Monitorimit, si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Projeksion ” sh.p.k. brenda afateve të përcaktuara në Rregulloren për Procedurat e Licencimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema